



Republika e Kosovës
Republik of Kosova
Republika Kosovo



Komuna e Vitisë
Municipality of Vitina
Opstina Vitina

Në bazë të nenit 35 paragrafi 1 dhe 5 të Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës Nr.04/L-032 dhe udhëzimit administrativ të MASHT-it Nr.13/2011, dhe Ligjit të Punës Nr.03/212 neni 8 pika 1, 2, Ligjin mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr.03/L-147, neni 4, pika 4, si dhe Udhëzimi Administrativ i MASHT-it Nr.06/2015 mbi përzgjedhjen dhe pranimin e kuadrit arsimor, Drejtoria për Arsimit shpall:

K O N K U R S P U B L I K

SHFMU “Nazmi Pajaziti” në Radivojcë

- Një (1) arsimtar për lëndën Gjuhë angleze, për një (1) vit shkollor,
- Një (1) mësues klasor, zëvendësim deri në kthimin e punëtores nga pushimi i lehonisë.

SHFMU “Hysen Terpeza” në Terpezë

- Një (1) arsimtar për lëndën Kulturë Fizike me kohë të pacaktuar,
- Një (1) mësues klasor, zëvendësim deri në kthimin e punëtores nga pushimi i lehonisë.

SHFMU “Mirali Sejdiu” në Goshicë

- Një (1) arsimtar për lëndën biologji, për 20 orë mësimore, zëvendësim deri në kthimin e punëtores nga pushimi i lehonisë.

SHFMU “Dëshmorët e Vitisë” në Viti

- Një (1) punëtor teknik (pastrues) me kohë të pacaktuar.

SHMP “Jonuz Zejnullahu” në Viti

- Një (1) profesor për lëndën komunikacion rrugor, për 14 orë mësimore, me kohë të pacaktuar.

Kandidatët të cilët konkurrojnë për pozitën e punëtorit teknik, duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të ketë diplomën e shkollës së mesme-fillore,
- Të ketë certifikatën e lindjes,
- Të ketë certifikatën se nuk është nën hetime,
- Të ketë certifikatën e gjendjes shëndetësore.

Kandidatët të cilët konkurrojnë për këto vende të punës, duhet të kenë përgatitje përkatëse profesionale, fakultetin (diplomën). Në mungesë të kandidatëve me përgatitje përkatëse profesionale, do të merren në shqyrtim kandidatët me përgatitje përkatëse profesionale më të ulët.

Kërkesat dhe aplikacionet për konkurrim merren dhe dorëzohen në Drejtorinë për Arsim të Komunës së Vitisë.

Afati i konkurrit është 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik.

Viti, më 22.08.2017

Drejtoria për Arsim